REPUBLIKA SHQIPERISE

GJYKATA RRETHIT TIRANE

NR AKTI 3810 NR VENDIMI 2602

# V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Rrethit Tiranë,e përbërë prej:

GJYQTARE - ENKELA BAJO

asistuar nga sekretare Xhuljeta Vejsiu,sot,më dt,19.7.2000,mori në shqyrtim në seancë gjyqsore me dyer të hapura çështjen civile që i përket:

K Ë R K U E S : Kujtim Caushku,i biri i Abdylit,dtl 1950,banues në Tir Tiranë.

Petrit Beci,i biri i Bqeremit,dtl 1957,banues Tiranë.

O B J E K T I : Regjistrimin si person juridik i shoqatës së "LUMNIER"

Baza ligjore N.42 e vijues i K.Civil.

Gjykata,pasi administroi provat shkresore të paraqitura,dëgjoi kërkuesin i cili në përfundim kërkoi pranimin e kërkesës,dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi,

# V E R E N

Se,pranë gjykatës Rrethit Tiranë,është paraqitur një kërkesë me anën e të cilës kërkohet rregjistrimi si person juridik i shoqatës "LUMNIER".

Siç rezulton nga materialet e paraqitura dhe nga procesverbali i mbledhjes së antarëve themelues,këta me vullnetin e tyre të lirë e të plotë,i kanë vendosur rregjistrimin e shoqatës Lumnier dhe kanë notarizuar aktin e themelimit dhe statutin me programin e tij si dhe kanë zgjedhur Z.Kujtim Caushku si kryetar të kësaj shoqate dhe Z.Petrit Beci si

si drejtor Ekzekutiv.

Kjo shoqatë siç rezulton dhe nga vetë dokumentat,është një organizatë jofitimprurëse dhe s'ka qëllime fitimprurëse.

Qëllimi i saj është i përcaktuar qartë në statut dhe në programin e saj.

- Krijimi i Cinematikës dhe i shkollës profesionale për evidentimin dhe programimin e vlerave të kinematografisë tonë duke bërë përpjekje për të hapur preshektiva për talentat e gjeneratat e reja.

- Studimi publik dhe individual i kulturës kinematografike

- edukimi i gjeneratave të reja në kinematografi.

- publikimi i studimeve,statistikave ,anketave dhe testeve për aktiviteti e kulturës kinematografike.

- Krijimi i infrastrukturave efektive për thithjen,përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit në fushën e kulturës dhe të artit kinematografik.

- Realizimin dhe promovimin e projekteve kinematografike nëpërmjet me nxhimit të kualifikuar pa qëllim fitimi.

- Realizimi i projekteve të porositura nga të tretët ,konsulenca e kualifikuar në fushën e kinematografisë.

- organizimi i vazhdueshëm i cinematikës,dhe shkollës profesionale të kinematografisë nëpërmjet kontaktave cinematike dhe shkollat e vendeve të Europiane.

Pregatitja e projektit ligjor,arkitektonik,teknologjik,e teknik në studio "ALBAFILM".

Njohja e shoqatës në Europë e më gjërë dhe mbajtja e kontakteve me shoqatat dhe fondacionet që ushtrojnë një aktivitet të tillë.

Të drejtat dhe detyrat e antarëve të kësaj shoqate janë në përputhje me ligjin në fuqi.

Organet kryesore të saj janë:

Mbledhja e Përgjithëshme e antarëve-është organi më i lartë vendimor.Kompetencat dhe organizimi i saj janë të përcaktuara në Statut në N.5/1

Bordi Konsultativ - është organi që vepron në periudhën ndërmjet dy mbledhjeve të përgjithshme të antareve.

Kopetenata dhe organizimi janë të përcaktuara në statut në N.5/2.

Kryetari dhe drejtori Ekzekutiv dhe detyrat e tyre janë të përcaktuar në statut në nenet 5/1 e 5/3.

Kryetari i shoqatës është Z.Kujtim Cashku e drejtori ekzekutiv është Petrit Beci.

Burimet financiare të shoqatës janë:

Kuotat e antarëve të shoqatës'

Donacionet nga persona apo institucione private apo shtetërore,brenda apo jashtë vëndit.

Financat që vijnë nga aplikimet e projekteve të hartuara dhe të porositës

Kontribute të tjera të lejuara nga ligji.

Shpërndarja e shoqatës bëhet sipas Statutit e ligjit në fuqi.

Selia e shoqatës ndodhet në Korpusin qëndror të Studenteve"ALBAFILM", Rr"A.SOLDIU" NR.76 TIRANË.

Kohëzgjatja e përcaktuar.

Në lidhje me të gjitha këto sa thamë më sipër dhe në bazë të dokumenteve të paraqitura dhe ligji në fuqi,gjykata, gmon se kërkesa e paraqitur është e rejtë dhe e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në n.126 deë 306 të K.Pr.C.,gjykata,

VENDOSI

Pranimin e kërkesës.

Rregjistrimin si person juridik të shoqatës"LUMENISR".

Kjo shoqatë është një organizatë jo qeveriatare dhe s'ka qëllim fitimprurës.Qëllimi i saj është i përcaktuar në statut dhe në programin e saj.

ORGANET DREJTUESE JANË:

-Mbledhja e përgjithëshme e antarëve të saj.

- Bordi Konsultativ

- Kryetari dhe drejtori ekzekutiv.Kryetari është Z.Kujtim Cashku dhe drejtori ekzekutiv është Z.Petrit Beci.

BURIMET FINANCIARE JANË:

- Kuotat e antareve
- Donacionet e ndryshme nga persona apo institucione private apo të huaja, vëndas apo të huaj.
- Kontributet e tjera të lejuara nga ligji.

Selia e Shoqatës ndodhet në Korpusin Qëndror të Studios "Albafilm" Rr"ALEKSANDER MOISIU" NR.76 TIRANË.

Kohëzgjatja e përcaktuar.

Shpenzimet gjyqsore nuk janë bërë.

Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit, brenda 15 ditëve duke fillu ar afati nga dita e shpalljes.

Tiranë dt.19.7.2000

SEKRETARE
XHULJETA VASHU

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJYKATA E RRETHIT TIRANE

GJYQTARE
ENKELA BAJO

VERTETOHET SE KY VENDIM
[illegible] FORME TE PRERE ME DT 02.08.2000
TIRANE
KRYESEKRETARE
[illegible]

02.08.2000

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJYKATA E RRETHIT TIRANE